



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:262741

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05521906

P.nr.554/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit K. B. nga L. të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.4971/2021, të datës 02.11.2021, për shkak të veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kerkesen e prokurorise për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seances gjyqësore me datën 11.11.2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP/II.nr.4971/2021, të datës 02.11.2021, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurit:

K. B., i lindur me ..., nga L. me vendbanim në rr. "N. T.", p.nr. ku edhe tani jeton, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, pronar i subjektit afarist "V. P." me seli në L., rr. "H. B." i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Më datën 04.02.2020, rreth orës 10:40, në Lipjan në subjektin afaristë "V. P.", pasi që inspektorët e kontrollimit i kishin vendosur shiritat zyrtar dhe ja kishin ndaluar përkohësisht punën, i pandehuri K. B., i kishte hequr shiritat dhe kishte vazhduar të punoj-

-me këtë ka kryer veprën penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform dispozitave të neneve, 1, 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 406 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 365 dhe nenit 495 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej 500-€, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin m gjobë do ta zëvendësojë konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

DETYROHET: i pandehuri që kësaj gjykate, në emer të paushallit gjyqësor ti paguaj shumën prej **20- €**, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit ti paguaj shumën prej **30-€**, në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP/II.nr.4971/2021, të datës 02.11.2021, e ka akuzuar të pandehurin K. B. nga L., për shkak të veprës penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par.1 të KPRK-së, dhe njëkohësisht ka kërkuar që të pandehurit ti shqiptohet urdhër ndëshkimor – dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi provat që janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht kallëzimit penal me nr.334-8765 të dt.10.02.2020,aktvendim i dt.05.02.2020, procesverbal për kontrollimin inspektues i dt. 04.02.2020, si dhe procesverbali për kontrollimin inspektues i dt. 07.02.2020 dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e dënoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit do ti shqyrtoj dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 (tri) vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 450 par. 2 nën par 2.1. dhe 2.6 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit u murr në bazë të nenit 39 par. 1 pika 1.3 të Ligj për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN

P.nr.554/21 me dt.11.11.2021

Sekretarja Juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi,

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:262741
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05521906